

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Spitalin Universitar të Traumës me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2014 deri më 30.09.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 171, datë 28.12.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën Nr. 788/7, datë 28.12.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Gjovalin Bushi, Drejtor i Spitalit Universitar të Traumës, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Bazat për opinion të kualifikuar mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare

Nga auditimi u konstatua se, Spitali Universitar i Traumës (SUT) nuk ka Regjistër të Aktiveve të hartuar në varësi të llojit, si edhe grupit përkatës brenda llojit (klasa ndërtesa), sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në mungesë të evidencave të duhura mbështetur mbi ISSAI 1500, grupi i auditimit nuk mund të japë siguri të arsyeshme sa i takon vlerësimit dhe kontabilizimit të pasurisë së këtij institucioni prej 1,918,020,373 lekë (reflektuar te Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara, lloji ndërtesë), **i cili përfaqëson 83% të totalit të Aktivit duke gjykuar se pasuria e institucionit e shprehur në Aktivin e Bilancit kontabël nuk është e saktë.**

Nuk është reflektuar në bilancin e vitit 2014 asgjësimi i aparaturës mjekësore Nistalmograf, me vlerë 26,000,000 lekë i kryer në vitin 2013. Gjithashtu kjo aparaturë pasqyrohet edhe një herë në kontabilitetin e institucionit me emërtimin EMG, pra e njëjta pajisje rezulton të jetë e regjistruar dy herë, por me emërtime të ndryshme. Rezultojnë të jenë gjendje dhe dy aparatura EMG përkatësisht, me vlerë 18,552,328 lekë dhe 25,907,014 lekë, por që nuk rezultojnë të jetë gjendje në inventarin fizik të SUT e nuk rezultojnë të jetë gjendje as në librat e kontabilitetit të trashëguara nga SUQU (ish Spitali Ushtarak) dhe të përditësuar nga sektori i financës së SUT, *veprime këto që kanë rritur fiktivisht vlerën e aktiveve të qëndrueshme për 96,459,342 lekë.* Konstatohet se, edhe pse SUT nga viti 2013 është në varësi administrative nga Ministria e Shëndetësisë, mjetet e transportit, me vlerë 20,708,518 lekë, janë aktualisht në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Nuk është pasqyruar në kontabilitet transferimi i një autoambulance, me vlerë fillestare 600,000 lekë në Shërbimin Spitalor Kurbin.

Kontabilizimi i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve të shoqërisë nuk është pasqyruar me saktësi në pasqyrat financiare. Konstatohet se çregjistrimi i aktiveve është kryer me koston fillestare të aktivit pa marrë në konsideratë vlerën e mbetur të tij referuar kjo VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006.

Auditimi i inventarit të barnave konstatoi 3 tipollogji problematikash:

Gjendja inventariale e disa lloje barnash, të paraqitur në bilancin e institucionit ka diferenca të konsiderueshme në krahasim me gjendjen e barnave pasqyruar në librat e kontabilitetit të mbajtur manualisht, si dhe të inventarit të barnave të deklaruara pranë FSDKSH-së më 31.12.2014. Kështu, në bilancin e institucionit pasqyrohen artikuj në vlerën 16,499,117 lekë, por që në librat manualë të kontabilitetit gjendja e tyre është 0.

Ndërsa në disa lloje të tjera barnash (lista bashkëlidhur) në bilanc janë paraqitur me gjendje 0, ndërsa në librat manualë të kontabilitetit dhe në inventarin e paraqitur pranë FSDKSH-së rezultojnë me gjendje për vlerën 3,237,198 lekë.

Nga auditimi rezultojnë me diferenca në sasi dhe çmim ndërmjet dy inventarëve të deklaruar, atij të bilancit të Spitalit Universitar të Traumës dhe inventarit të raportuar më 31.12.2014 pranë FSDKSH-së. Vlera e deklaruar në bilancin e Spitalit Universitar të Traumës për 28

artikuj të audituar është 3,149,325 lekë, ndërsa vlera e raportuar në FSDKSH është 2,978,498 lekë, me një diferencë në raportim për 170,827 lekë më shumë.

Për artikullin gaz i lëngshëm(nevoja spitalore) ka një pasqyrim jo të drejtë të sasisë së konsumuar, me efekt në uljen fiktive të shpenzimeve për vlerën 11,622,389 lekë.

Spitali Universitar i Traumës nuk ka të dhëna për origjinën e krijimit të detyrimeve debitorë, të cilët në mbyllje të periudhës ushtrimore rezultojnë në shumën 2,512,000 lekë, si dhe mungon evidenca e ndjekjes së tyre.

Në gjykimin e KLSH-së, si edhe mbështetur në ISSAI 1705¹, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara te “Bazat për opinion të kualifikuar”, pasqyrat financiare vjetore të Spitalit Universitar të Traumës paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Institucionit Spitali Universitar i Traumës më datë 31.12.2014 dhe rezultatet e operacioneve dhe flukseve të arkës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Është në përgjegjësinë tonë, si auditues të pavarur, të shprehemi se, evidencat e auditimit të ofruara për çështjen e aktiveve ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 559, datë 26.10.2009 “Për përcaktimin e çmimeve në sistemin shëndetësor shtetëror” tarifa e mbajtur pacientëve të shtruar, por të pasiguruar, nuk përfshihet në listën e tarifave të miratuara. Gjithashtu, shërbimet e tjera që merr një pacient i pasiguruar, i shtruar, nuk ka tarifa të përcaktuara.

Nga auditimi konstatohet se, për rastet e shtrimeve të pacientëve të pasiguruar nga recepsioni dhe arka pritej një mandat arkëtimi i dytë me *tarifë 3,000 lekë*, edhe pse për vizitën të mjeku specialist patienti ka arkëtuar një tarifë të tillë, duke zbatuar urdhrat e ish Drejtorit nr. 67, datë 04.03.2013, ndryshuar me urdhrin nr. 322, datë 02.07.2013. *Me anë të këtij veprimi patienti shtrohet dhe kryen ekzaminimet që përcaktohen në kartelën klinike në të gjitha shërbimet, duke filluar nga analizat laboratorike, ekzaminimet, përfshirë dhe terciaret e deri në kryerjen e operacioneve kirurgjikale, të cilat kanë kosto të lartë për shërbimin spitalor.* Nga të dhënat statistikore rezulton se, peshën më të madhe në ekzaminimet imazherike, laboratorike e konsulta e zënë ato të kryera për pacientët e shtruar, por të pasiguruar kundrejt pacientëve të siguruar, si dhe rastet e urgjencës.

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 558, datë 26.10.2009 “Për regjistrimin, identifikimin dhe lëvizjen e pacientit brenda Institucioneve shëndetësore, në zbatim të sistemit të referimit”, pika 12, kërkohet që “Pacientët e pasiguruar do të paguajnë sipas tarifave të miratuara, për çdo shërbim që marrin, edhe nëse janë të rekomanduar”, ndërsa në pikën 12 të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 526, datë 12.10.2009 “Për zbatimin e sistemit të referimit të pacientëve në shërbimin shëndetësor”, përcaktohet se “Të gjithë personat që nuk zbatojnë sistemin e referimit do të përfitojnë shërbime sipas tarifave të shërbimit shëndetësor të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe të afishuara në institucionet publike”. Nga përllogaritjet e bëra vetëm për ekzaminimet imazherike konstatohet se, nga kryerja e këtyre shërbimeve për pacientët e pasiguruar për periudhën objekt auditimi, rezultojnë të ardhura të munguara për institucionin, respektivisht për vitin 2014 në shumën 3,623 mijë lekë dhe për 9/mujorin e vitit 2015 në shumën 974 mijë lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

¹ **ISSAI 1500:** Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedura auditimi, në mënyrë që të sigurojë evidenca të mjaftueshme, relevante dhe të besueshme

¹ **ISSAI 1705:** Objektivi i audituesit është të shprehë qartë një opinion të modifikuar mbi pasqyrat financiare, i nevojshëm nëse (...) audituesi e ka të pamundur të sigurojë evidencat e duhura për të konkluduar se, pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale dhe që transaksionet e kryera, përputhen në të gjitha aspektet materiale me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Për të gjitha shërbimet shëndetësore, për të cilat nuk ka tarifa të përcaktuara, nga ana e Spitalit Universitar të Traumës, të hartohet një listë shërbimesh me tarifa dhe të kërkohet miratimi nga Ministria e Shëndetësisë. Ky rregullim do t'i presë rrugën çdo mundësie për shmangien e tarifave, apo abuzimeve me to.

Menjëherë

2. Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua se: Gjatë periudhës së auditimit, i janë paguar firmës “U. A” sha (sot “S. A.”) gjithsej **116,561,314 lekë**, për shërbimin e hemodializës, i cili është ofruar përgjatë vitit 2014 për 60 pacientë, në bazë të kontratës së rinovuar më datë 19.03.2014, shërbim që në vitin 2015 nuk është i kontraktuar nga institucioni. ***Rakordimi mujor me S. A. është bërë me bazë mirëbesimi, SUT nuk disponon asnjë dokument monitorimi të këtij shërbimi, në kundërshtim të plotë me nenin 6 “Detyrimet dhe të drejtat e “blerësit”(SUT)” të kontratës nr. 146 datë 15.04.2010 “Për dhënien e shërbimit të dializës për pacientë”, pika 6/2, ku citohet: “Blerësi (SUT), duhet të monitorojë cilësinë e shërbimit, bazuar në parametrat e cilësisë si, mortaliteti, malnutricioni, infeksionet, Kt/V, niveli i Hb, TA paradializës, ditë qëndrimi në spital, organizimi i procedurave dialitike, skedat dhe kartelat e ndjekjes dhe mjekimit” dhe pika 6/3, ku citohet: “Blerësi ka të drejtë të ushtrojë kontroll, nëpërmjet personave të autorizuar prej tij dhe që i bën të njohur “dhënësit”, për pritjen korrekte dhe informimin për pacientet që do të marrin shërbimin e dializës, sipas kësaj kontrate. Për kontrollet e ushtruara, mbahet procesverbali përkatës, i cili nënshkruhet edhe nga përfaqësuesi i dhënësit”. Si rezultat i mungesës së dokumentacionit të monitorimit, grupi i auditimit nuk ka marrë siguri për kryerjen e këtij shërbimi konform kushteve të kontratës. Për sa më sipër, trajtuar në faqe 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:***

Spitali Universitar i Traumës, të marrë masa për saktësimin dhe plotësimin e dokumentacionit të munguar në monitorimin e shërbimit të paguar. Në të ardhmen, nga Nëpunësi Zbatues të eliminohen praktika të likuidimit të shpenzimeve pa dokumentacionin e plotë justifikues për monitorimin e shërbimeve të marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Nga auditimi mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit rezultoi se, nga SUT kontabiliteti mbahet në dy mënyra, atë manuale (bën regjistrimet manuale në librat e kontabilitetit të trashëguara nga Spitali Ushtarak i Qendror Universitar) dhe paralelisht përdor dhe programin financiar “Alfa”. Aktualisht, programi financiar “Alfa” u lejon të gjithë përdoruesve kryerjen e modifikimeve dhe fshirjes së të dhënave, pra komprometon sigurinë në sistemin e të dhënave. Për sa më sipër, trajtuar në faqe 33-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Nga Drejtoria Ekonomike e Spitalit Universitar të Traumës të merren masat e nevojshme që, kryerja e modifikimeve në programin financiar “Alfa” të bëhet vetëm nga një person përgjegjës, i cili mund të ndryshojë apo ndërhyjë duke lënë gjithmonë gjurmë dhe duke argumentuar arsyen e kësaj ndërhyrje, për të shmangur veprimet e pa autorizuara. Për çdo rast të modifikimit të veprimeve, të mbahet një procesverbal dypalësh me personin përgjegjës për veprimin apo regjistrimin e gabuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se:

-Nga SUT, nuk disponohen të dhëna të sakta të aseteve që administrohen prej saj, si dhe nuk disponohet regjistër kontabël i aseteve të dhëna me qira. Dorëzimi i aseteve nga Spitali Ushtarak Qendror Universitar (SUQU) në Spitalin Universitar të Traumës (SUT) nuk është bërë konform kërkesave të legjislacionit për kontabilitetin dhe menaxhimin financiar e kontrollin. Ky kalim nuk është bërë me komision dypalësh, por në mënyrë të njëanshme, pasi dokumentacioni financiar së bashku me personelin ka kaluar pranë Spitalit Universitar të Traumës.

-Në bilancin e SUT, nuk pasqyrohet vlera e ndërtesës, në dy raste janë përfshirë dy herë makineri dhe pajisje me emërtime të ndryshme, si dhe pasqyrohen pajisje që nuk ekzistojnë, (janë asgjësuar). Me kalimin e përgjegjësisë administrative nga Ministria e Shëndetësisë, nuk

është bërë kalimi i pronësisë nga Ministria e Mbrojtjes për mjetet e transportit, ndërsa në rastin e kalimit të një mjeti për Spitalin e Kurbinit, nuk është kryer veprimi i heqjes së tij nga kontabiliteti i institucionit.

-Konstatohet se, ka diferenca të konsiderueshme të gjendjes së barnave, të paraqitur në bilancin e institucionit, në krahasim me të dhënat në librat e kontabilitetit dhe të inventarit të barnave të deklaruara pranë FSDKSH-së më 31.12.2014.

Në inventarin kontabël bashkëlidhur bilancit, ka artikuj që nuk janë pasqyruar, ose pasqyrohen artikuj të cilët, referuar fletë daljeve, kanë kaluar për konsum dhe në disa raste ka ndryshime të çmimeve të artikujve.

Nga Spitali Universitar i Traumës nuk disponohen të dhëna analitike për krijimin e detyrimeve debitorë, si dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për arkëtimin e tyre. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 33-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

-Spitali Universitar i Traumës në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Shëndetësisë, të administrojë të gjithë dokumentacionin financiar të periudhës para vitit 2013, si dhe të marrë masa për hartimin e një *data baze* të plotë të të gjithë aseteve ish pronë e SUQU-së. Kjo *data bazë* duhet të përmbajë minimalisht, përshkrimin e aktivit, amortizimin e akumuluar në vite, vlerën e mbetur të aktivit deri në datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim të aktivit nga Spitali Universitar i Traumës. Në mbyllje të procedurës së mësipërme, bazuar në procesverbalin dypalësh të dorëzimit të aseteve dhe referuar këtyre të dhënave, Spitali Universitar i Traumës duhet të hartojë **regjistrin e aktiveve**, duke e përditësuar atë me të gjithë ndryshimet e ndodhura përgjatë viteve në vazhdim.

-Sektori i Financës së Spitalit Universitar të Traumës, pasi të disponojë regjistrin e plotë të aktiveve të bëjë rillogaritjen e amortizimit të aktiveve dhe të sistemojë në llogaritë përkatëse të gjitha diferencat e krijuara si rezultat i regjistrimeve të gabuara në tërësi.

-Spitali Universitar i Traumës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Shëndetësisë duhet të marrë masa për kalimin e pronësisë së aktiveve, kjo referuar varësisë së përgjegjësisë së administrimit të tij.

-Spitali Universitar i Traumës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të kryejnë evidentimin saktë të detyrimeve debitorë, origjinën e tyre, me dhe pa shpresë arkëtimi dhe të ndjekë në rrugë gjyqësore, të gjitha detyrimet që janë gjendje në fund të vitit 2014, sipas të dhënave të bilancit kontabël, të rakordojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet duke bërë evidentimin dhe sistemimin e diferencave eventuale, para nxjerrjes së pasqyrave financiare përfundimtare të periudhës ushtrimore.

Brenda datës 31.03.2016

5. Nga auditimi i dokumentacionit për inventarizimin e pronës shtetërore u konstatuan veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenin 73 të kapitullit “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, nenin 83 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin”, nenin 85 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin”, nenin 95 dhe 100 të kapitullit “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” dhe nenet 112,113 të kapitullit “Përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme” si më poshtë:

5.1. Në lidhje me funksionimin e komisionit të inventarizimit të vitit 2014 u konstatua se:

a) Komisioni i inventarizimit të hotelerisë dhe komisioni i pajisjeve mjekësore nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjësin e materiale, për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit, nuk kanë përpiluar relacion në lidhje me inventarizimin fizik të pajisjeve, për kushtet fizike të ruajtjes së tyre, etj.

b) Fletëve të inventarit të pajisjeve mjekësore të sallave të operacioneve, reaminacionit dhe urgjencës kirurgjikale, kanë të plotësuar vetëm kolonat që i referohen të dhënave të kontabilitetit, mungojnë të dhënat e gjendjes së inventarit fizik të aktiveve, si dhe të dhënat e rezultatit të dalë nga inventarizimi.

5.2. Në lidhje me funksionimin e komisioneve të vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimi të tyre dhe komisionit të asgjësimit të aktiveve u konstatua se:

a) Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimi janë të përbërë nga tre persona, nuk janë mbështetur në një raport, të përpiluar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve, nuk ka hartuar relacion për procedurën që ka ndjekur për vlerësimin e këtyre aktiveve dhe propozimin përkatës.

b) Për disa aktive, të vlerësuara si aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit, mungon data e hyrjes së aktiveve, ka mungesa të çmimeve të aktiveve, në asnjë rast nuk është shënuar vlera e mbetur e aktivitetit, kjo pasi të jetë llogaritur vlera e amortizimit, si dhe nuk ka një vlerësim kosto-përfitim të aktiveve të vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

*Për sa më sipër, trajtuar në faqe 39-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Spitali Universitar i Traumës, të marrë masa për ribërjen e inventarizimit të aseteve, nxjerrjen e rezultatit të tij, sistemimet e duhura në raste të diferencave, si dhe veprimet e mëtejshme në zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe të nxirret përgjegjësia për veprimet apo mosveprimet e personave të ngarkuar për zbatimin e rregullshmërisë së këtij procesi.

Brenda datës 31.03.2016

6. Nga auditimi u konstatua se, praktika e dhënies më qira të subjektit “S..... A.” (ish “U.....-A.” sh.a), nuk ka të gjithë dokumentacionin ligjor të nevojshëm për monitorimin e kontratës, si: procesverbalet e hollësishme për mënyrën e dorëzimit dhe të marrjes në dorëzim të objektit duke përshkruar në detaje gjendjen fizike të objektit deri në fotografim të çastit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, Kreu VI “Monitorimi i kontratave”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se, nga SUT janë kryer matje të sipërfaqeve, të cilat përdoren nga “S..... A”, referuar kontratës së qirasë së lidhur më datë 28.08.2013, duke konkluduar që ky subjekt përdor ambiente brenda spitalit gjithsej 1963.7 m², nga të cilat vetëm 496 m² i janë dhënë me qira. Për këto ambiente, SUT i është drejtuar subjektit “S...A”, duke i njoftuar për sipërfaqet që ai përdor më tepër, por dhe detyrimin për periudhën nga 26.07.2011 në shumën 11,222,689 lekë. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 46-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Nga Spitali Universitar i Traumës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, si ministria përgjegjëse për administrimin dhe me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e pronarit, të kërkohej zgjidhja e statusit të sipërfaqeve të tepërta që administron subjekti “S..A”, deri në lirim të ambienteve ose lidhjen e kontratës për ambientet e shfrytëzuara jashtë kontrate.

Nga SUT, të merren masa të menjëhershme për plotësimin e dosjes së subjektit “S.. A.” me të cilin janë lidhur kontrata qiraje, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9451, datë 06.11.2003 “Mbi arkivat”, neni 7 dhe të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Të merren masa, që të plotësohen praktikat e monitorimit të kontratave të qirasë me dokumentacionin e kërkuar nga VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Menjëherë

7. Nga auditimi konstatohet se, subjekti “S.. A” përdor dhe një sipërfaqe prej 222.3 m², të cilën e ka ndërtuar mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leje ndërtimore apo kontratë. Po kështu ka ndërtuar dhe një urë lidhëse ndërmjet godinës së tij dhe spitalit, me sipërfaqe 45 m², për të cilën nuk ka dokumente në SUT, çka konfirmohet dhe nga kartela e pasurisë bashkëlidhur Certifikatës së pasurisë së

datës 07.04.2015, ku përshkruhen 3 objekte pa leje apo “ndërtime të paligjshme”. Për këto ambiente ky subjekt nuk paguan qira.

*Për sa më sipër, trajtuar në faqe 46-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:*** Nga Ministria e Shëndetësisë, të merren masat për ngritjen e një grupi pune, i cili të bëjë përcaktimin e statusit juridik të këtyre pronave dhe pretendimet e shtetit ndaj tyre.

Nga Spitali Universitar i Traumës, në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të merren masat e duhura për evidentimin dhe saktësimin e këtyre ndërtimeve, si dhe të informojë ministrinë përgjegjëse.

Menjëherë

8. Nga auditimi konstatohet se, gjatë vitit 2013 dhe 2014 nga SUT, referuar urdhrave të Ministrit të MZHETS dhe të Ministrit të Shëndetësisë, janë prishur kontratat e lidhura me subjektet private për dhënien me qira të ambienteve të spitalit. Si rezultat i ndërprerjes para kohe të këtyre kontratave, SUT jo vetëm është në procese gjyqësore të zgjatura me katër subjekte, të cilat kanë kërkuar “të ardhura të munguara”, por ambientet e saj janë të bllokuara nga përmbaruesit gjyqësorë dhe të papërdorshme, në një kohë që ky shërbim spitalor ka nevojë të domosdoshme për ambiente. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Nga Spitali Universitar i Traumës, të merren të gjitha masat për ndjekjen e procedurave ligjore të mëtejshme, deri në lirim të ambienteve dhe përdorimin e tyre për nevojat e Spitalit, si dhe të kërkohet ndërhyrja e Ministrisë së Drejtësisë për zgjidhjen ligjore të kësaj situatë.

Menjëherë

9. Nga auditimi konstatohet se, në magazinën e spitalit ka artikuj stok të llojeve të ndryshme të cilat gjenden të pasqyruara në librat e magazinës, gjithsej 24 artikuj, në vlerën 35 milion lekë. Peshën kryesore e zënë materialet e buta, për 17 artikuj, të cilët kanë ardhur kryesisht si donacion në vitet 2001- 2004 nga Qeveritë Italiane, Gjermane dhe USA, për ish Spitalin Ushtarak dhe mbahen në pjesën më të madhe në disa kontenierë në ambientet e jashtme të spitalit. Nga ana e SUT, për nevoja të saj, është përdorur vetëm një sasi e vogël e tyre, pasi janë materiale të prodhuara shumë vite më parë dhe të një cilësie të dobët, si rezultat i mbajtjes në magazinim për një kohë të gjatë.

Po kështu janë gjendje në magazinë dhe 7 gjeneratorë, të dhuruar, të cilët nuk janë vënë në punë asnjëherë nga SUT, për shkak të normativave të larta të konsumit të karburantit.

Konstatohet se, janë gjendje në magazinë pjesë këmbimi e vegla, për 506 artikuj, si dhe goma automjetesh, të trashëguara nga SUQU ndër vite dhe për tipe të ndryshme automjetesh, të cilat aktualisht në pjesën më të madhe të tyre nuk janë në qarkullim. Mbajtja në magazina e këtyre materialeve të panevojshme, jo vetëm që qëndron padrejtësisht në aktivet e institucionit, por dhe bllokun ambiente të konsiderueshme.

*Për sa më sipër, trajtuar në faqe 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Nga Spitali Universitar i Traumës, të merren masa të menjëhershme për evidentimin, saktësimin dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve dhe mallrave stok, vënien në dispozicion të tyre për institucione të tjera brenda dhe jashtë sistemit, si dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme të nevojshme, sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

10. Nga auditimi rezulton se, konsumi i medikamenteve dhe materialeve mjekësore bëhet sipas kërkesave të shërbimeve referuar kartelave të të sëmurëve. Konstatohet se për të gjitha shërbimet që kryhen në Spitalin Universitar të Traumës nuk disponohen Protokolle të Praktikës Klinike, të miratuara nga MSH posaçërisht për Spitalin e Traumës, por punohet me udhëzues dhe protokolle ndërkombëtare, si dhe ato të miratuara për QSUT. Po kështu dhe për konsumin e kiteve dhe të reagentëve në laboratorë nuk kishte manual apo ndonjë udhërrëfyes. Hartimi i protokolleve dhe manualeve, si për barnat dhe materialet e tjera mjekësore do të ishin dhe pika e referimit për planifikimin e nevojave dhe konsumin e tyre në tërësi. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Nga Spitali Universitar i Traumës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, të merrem masa për hartimin dhe miratimin e Udhërrëfyesve dhe Protokolleve të Praktikës Klinike, posaçërisht për traumën, të manualeve për konsumin e kiteve dhe të reagentëve në laboratorë, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dhe monitorimit të zbatimit të tyre.

Menjëherë

11. Nga auditimi konstatohet se, monitorimi i shërbimeve spitalore të traumës dhe përlllogaritja e koston së tyre realizohet nga njësia nëpërmjet programit “Kosto Spitalore”. Në këtë program hidhen shpenzimet e kryera për secilin shërbim, bazuar në kartelat e të sëmurëve, në daljet e farmacisë, magazinave, pagat e personelit, etj., duke përlllogaritur shpenzimet direkte dhe ato indirekte, si dhe koston për diagnozë.

Konstatohet se shpenzimet e këtij spitali rëndohen padrejtësisht dhe me shpenzimet e pavijoneve që shfrytëzohen nga shërbimi i ortopedisë që i përket QSUT (Ky shërbim operon për një kohë të gjatë brenda ambienteve të SUT) sikurse janë ushqimi i të sëmurëve, shpenzimet e pastrimit, oksigjenit, ujë, energji elektrike dhe materiale mjekimi, të cilat përfaqësohen në koston e shërbimit si shpenzime indirekte.

*Për sa më sipër, trajtuar në faqe 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:*** Nga Spitali Universitar i Traumës, të analizohet dhe ndahet kosto e këtyre shërbimeve, duke pasqyruar në shpenzime vetëm vlerën e shërbimit që i referohet pacientëve që kurohen prej tij, ndërsa për pjesën takuese të QSUT, në fund të vitit të kryhen rakordimet dypalëshe dhe të bëhet faturimi i shërbimeve.

Menjëherë

12. Nga auditimi konstatohet se, nga SUT, në mbështetje të sistemit të referimit, janë realizuar të ardhura dytësore, përkatësisht për vitin 2014 për 3,577 mijë lekë dhe për 9/mujorin e vitit 2015, për 3,551 mijë lekë. Për vjeljen e këtyre të ardhurave, është organizuar një sportel (reception), në ambulatorin qendror, pranë së cilës punojnë një arkëtar dhe dy infermierë receptioni, por që për vetë territorin e gjerë ku ushtrohet aktiviteti nuk u jep pacientëve orientim të plotë për kryerjen e shërbimeve.

Plotësimi i të dhënave në regjistra dhe në librat e arkës bëhet në mënyrë manuale, pasi receptioni nuk është i pajisur me pajisje kompjuterike dhe as me linjë telefonike, duke mos bërë të mundur nxjerrjen e të dhënave në kohë reale dhe as informimin e të interesuarve për marrjen e shërbimit.

Për zbatimin e sistemit të referimit në këtë spital nuk ka dokumentacion për monitorimin e vazhdueshëm të sistemit, problematikat e rezultuara dhe masat e marra.

*Për sa më sipër, trajtuar në faqe 116-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Nga Spitali Universitar i Traumës, të merrem masa për riorganizimin e receptionit të spitalit, vendosjen e tij në vend të dukshëm, në mënyrë që të realizohet dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me pacientët, pajisjen me sistemin kompjuterik, si dhe *monitorimin e vazhdueshëm nga strukturat menaxhuese në drejtim të zbatimit të sistemit të referimit.*

Menjëherë

13. Nga auditimi rezultoi se, *menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Spitalin Universitar të Traumës ka funksionuar në nivele të ulëta, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin është kuptuar pjesërisht dhe ka funksionuar vetëm në disa hallka të njësisë dhe për pasojë, drejtuesi nuk ka mundur të bëjë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, pasi:*

Nga SUT, nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm; nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësoin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së; nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara; njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave

dhe mënyrën e dokumentimit të tyre; njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

Gjithashtu, njësia nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut; nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave, etj. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

- Spitali Universitar i Traumës të marrë masat e duhura, që në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë tek nëpunësi autorizues në ministri, deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë vitit të mëparshëm buxhetor për njësinë publike që mbulon, si dhe pyetësin e vetëvlerësimit. Të hartojë dhe miratojë Kodin Etik, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një procedurë me qëllim raportimin e shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

- Spitali Universitar i Traumës, të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të shoqërisë, me qëllim që të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore. Me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

- Spitali Universitar i Traumës, të marrë masat e duhura për të miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

- Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, Spitali Universitar i Traumës të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

- Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, Spitali Universitar i Traumës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, të hartojë programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, punonjësit të trajnohen dhe për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ka funksionuar dobët këtë njësi. Gjithashtu, të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

- Spitali Universitar i Traumës të marrë masa, në bashkëpunim me FSDKSH, për përfundimin e instalimit të programit “Administrimi dhe Monitorimi i Shpenzimeve Spitalore”, nëpërmjet të cilit do të menaxhoheshin pothuajse të gjitha aktivitetet e spitalit, si farmacia, magazinat, blerjet dhe shpenzimet, shërbimi spitalor, etj., që do të bënte të mundur jo vetëm nxjerrjen në kohë dhe të saktë të dhënave, por edhe monitorimin e të gjithë shërbimeve të spitalit, si ato mjekësore dhe ato financiare, pasi deri në momentin e përfundimit të këtij auditimi ky sistem konsiston vetëm në instalimin e një posti në sektorin e financës dhe të disa trajnimeve të punonjësve.

- Spitali Universitar i Traumës të marrë masa për vendosjen e linjave dhe gjurmëve të komunikimit, sipas kushteve dhe rrethanave në të cilën zhvillohet aktiviteti.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Nga auditimi i dokumenteve për matjen e sasisë të ujit të furnizuar nga UKT dhe pagesat e kryera për vitin 2104 dhe 9 mujorin e vitit 2015, është konstatuar përdorimi i veprimeve të

parregullta administrative nga UKT, si mbifaturime, faturime aforfe të ujit, apo nga vetë SUT, si përdorimi i ujit pa pagesë nga operatori ekonomik që realizon kontratën e ushqimit e pastrimit në SUT etj. Shpenzimet për ujin në Spitalin Universitar të Traumës, (në vitin 2014 rreth 34 milion lekë, në nëntëmujorin e vitit 2015 rreth 17 milion lekë), rëndojnë kostot e shërbimeve spitalore e kanë pasoja negative në administrimin financiar në institucion. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 111-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

- Të vazhdohet me ndjekjen e rrugës ligjore për zgjidhjen e problemit për mbifaturimet e faturimet aforfe të ujit, nëpërmjet shfrytëzimit të dokumentacionit që disponohet nga SUT (si aktrakordimet e grupit të punës në SUT, me përfaqësuesit e Ujësjetës-kanalizimeve Tiranë, faturat afrofe, përdorimi i të dhënave të kontatorit të ujit etj). Juristët e SUT të ndjekin këtë problem jo vetëm me UKT, por dhe me Entin Rregullator të Ujit, me qëllim që pagesa të bëhet nga SUT vetëm për ujin e konsumuar.

- Të rishikohen kontratat me kontraktuesin “S...A” shpk, i cili kryen në SUT shërbimin e kateringut të ushqimit, të pastrimit të ambienteve të brendshme e të jashtme si dhe të gjelbërimit që nga viti 2010, (neni mbi detyrimet e autoritetit kontraktues). Sipas kontratave ekzistuese, kontraktuesi, pa ndonjë argument ligjor, është lejuar të përdorë pa pagesë ujin për larjen e ambienteve të brendshme e të jashtme, ujitjen e pemëve dekorative e lulishteve etj, dhe për larjet në mensë e minikuzhina.

Në vijimësi

15. Nga auditimi i dosjeve me dokumentet e punës e të vlerësimit të punonjësve, u konstatuan mangësi e parregullsi, dokumente fotokopje e të panoterizuara, mungesa lidhur me vlerësimin periodik të punës së punonjësve etj. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 24-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

- Sektori i Burimeve Njerëzore në SUT, të marrë masa për plotësimin e dosjeve individuale të punës me dokumentet që mungojnë ose që nuk janë të rregullta.

- Për çdo pozicion pune të bëhet përshkrimi i operacioneve dhe detyrave që do të kryhen nga punonjësi.

- Të ngrihet sistemi i vlerësimit të punës të punonjësve për punën e kryer dhe të bëhet dokumentimi i tij, duke e arkivuar atë.

Menjëherë

16. Në auditimin e procedurave të prokurimit është konstatuar:

- Në disa raste janë vendosur kriteret diskriminuese për kualifikim, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” dhe që nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe volumet e preventivit, duke sjellë numër të kufizuar të operatorëve pjesëmarrës në tenderë,

- Janë kryer disa procedura “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për të njëjtin shërbim, ku vlera totale e fondeve të prokuruar brenda një viti kalendarik, e kalon kufirin e ulët monetar,

Gjatë vitit janë kryer disa procedura me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” të paargumentuara dhe për neglizhencë të Autoritetit Kontraktor, duke i trajtuar si raste emergjente dhe nevoja ekstreme,

Argumentimi dhe përllogaritja e fondit limit, përgjithësisht bëhet me testimin e tregut dhe në disa raste pa analiza kostoje, duke neglizhuar në shumë raste kontratat paraardhëse dhe duke bërë që fondit limit të mos jetë real. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 51-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

- Njësia e Prokurimit, apo strukturat e caktuara për vendosjen e kriterëve të kualifikimit, të marrin masa që të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre dhe të përputhen në natyrë dhe sasi me preventivat e objekteve që prokurohen.

- Të merren masa që, gjatë fazës së hartimit të buxhetit vjetor, të bëhet parashikimi i drejtë i nevojave dhe llogaritja e saktë e vlerës totale për prokurim brenda vitit ushtrimor, për të

njëjtin shërbim, në mënyrë që të mos bëhet ndarja e prokurimeve, me qëllim shmangien e procedurës së hapur.

-Të merren të gjitha masat, që prokurimi i shërbimeve dhe i mallrave në sistemin elektronik të APP-së, të fillojë në kohën e duhur, për të bërë të mundur shmangien e procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për nevoja ekstreme” dhe realizimin e procedurës “E hapur”, me qëllim përdorimin me ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit.

-Të merren të gjitha masat, që grupet e punës të ngritura për argumentimin dhe përllogaritjen e fondit limit, të bëjnë këtë përllogaritje duke bërë kombinimin e të dy metodave (testimin e tregut shoqëruar me analiza dhe marrjen në konsideratë të çmimeve në kontratat paraardhëse), në mënyrë që fondi limit të jetë sa më afër vlerës reale.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Nga auditimi mbi menaxhimin financiar në Spitalin Universitar të Traumës, ka rezultuar se organizimi dhe veprimtaria administrative, mbështeten në një rregullore të brendshme të vitit 2010. Në vitin 2014, SUT ka përgatitur draftin e rregullores së re, i cili akoma nuk është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Të punohet për plotësimet në draftin e rregullores të përgatitur në vitin 2014 (nëse është e nevojshme), të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj me strukturat e funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës.

Në vijimësi

18. Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua se:

-Gjatë vitit 2014, Spitali Universitar i Traumës ka likuiduar shpenzime përmbartimore gjithsej në shumën 362,327 lekë, referuar Urdhrit të Ekzekutimit nga Përmbartuesit Privatë Gjyqësorë, por mungon fatura fiskale e shoqërive përmbartimore, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të kontabilitetit dhe të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Si rezultat i arritjes me vonesë të medikamenteve mjekësore në magazinë, Spitali Universitar i Traumës gjatë vitit 2014, ka aplikuar penalitete ndaj furnitorëve në vlerën totale 1,364,890 lekë. SUT nuk disponon procesverbal dypalësh, apo faturë fiskale të lëshuar nga shitësi, në lidhje me mbajtjen e këtyre penaliteteve.

-Pavarësisht se malli (ilacet) është lëvruar nga furnizuesi më vonë seç është parashikuar në kontratë, në të gjithë procesverbalet e pritjes së mallit është cituar: “Malli u kontrollua nga komisioni dhe artikujt janë sipas standardeve, specifikimeve teknike, e brenda afatit të kërkuar”.

- Spitali Universitar i Traumës për vitin 2014 ka paguar në total 93,979 lekë gjoba për vonesa në likuidim dhe për periudhën Janar-Shtator 2015 ka paguar 2,699 lekë. Këto pagesa vijnë si rrjedhojë e mos likuidimit në kohë të detyrimit të taksave të bashkisë të vitit 2013 dhe faturave të shërbimit të telefonisë fikse përgjatë vitit 2014 deri më 30.09.2015. *Për sa më sipër, trajtuar në faqe 27-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit **rekomandojmë:***

Spitali Universitar i Traumës, të marrë masa për saktësimin dhe plotësimin e dokumentacionit të munguar për shërbimet e paguara dhe në rastet e likuidimit me vonesë të nxjerrë përgjegjësitë e secilit, si dhe të marrë masa për likuidimin e dëmit.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

I. Nga SUT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, **në shumën 8,267,033 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për rastet e mëposhtme:

1. Nga auditimi konstatohet se, nga subjekti “S.. A” janë përdorur *pa kontratë dhe pa pagesë sipërfaqja e tepërt prej 1200 m²*, referuar kontratës së qirasë së datës 28.08.2013, të lidhur me

ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, duke i shkaktuar SUT dëm ekonomik në shumën 7,560,000 lekë.

2. Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet Rezonanca Magnetike MRI”, u konstatua diferencë në volumet e punimeve të kryera në fakt, krahasuar me preventivin e objektit, si pasojë e të cilave është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve “G...” sh.p.k, *vlera prej 438,140 lekë*.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e prokurimit “Shërbimi i lavanderisë për vitin 2015”, si kontratues i fundit është marrë ai i kontratës nr. 36/10, datë 09.06.2014 me vlerë 6,238,159 lekë me tvsh, ndërkohë që kontrata e fundit është ajo me nr. 99/7 datë 29.10.2014, me vlerë 2,301,049 lekë me tvsh. Përveç faktit që referimi i gabuar i kontratës së fundit ka sjellë rritjen e vlerës së kësaj kontrate shtesë, konstatohet gjithashtu që çmimet/njësi të dy kontratave janë të ndryshme. Diferenca e çmimeve të dy kontratave ka shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 268,893 lekë, e cila të arkëtohet prej punonjësve të Sektorit të prokurimeve I.. K., G.. H.. dhe A... Zh...

II. Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, në cilësinë e poseduesit të fondeve për shlyerjen e paketave mjekësore, të kalojë në favor të SUT, detyrimin në shumën 11,784,019 lekë, që “S...A...” i detyrohet këtij institucioni, përkatësisht:

1. Në shumën 11,222,689 lekë, pasi nga matjet e kryera nga SUT të sipërfaqeve që përdoren nga “S.. A...”, ka rezultuar që ky subjekt, prej datës 26.07.2011, përdor ambiente brenda spitalit gjithsej 1963.7 m², nga të cilat vetëm 496 m² i janë dhënë me qira.

2. Në shumën 561,330 lekë, pasi nga subjekti për periudhën objekt auditimi, është përdorur pa kontratë dhe pa pagesë sipërfaqja prej 267.3 m², e ndërtuar nga vetë subjekti mbi ambientet në pronësi dhe në administrim të SUT, pa asnjë dokumentacion, referuar Kreut III, pika 2 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, me ndryshime.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, Dega Tiranë.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, neni 15, për shkelje të nenit 7, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,

Mbështetur në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, neni 15, për shkelje të nenit 7, **i rekomandoj** Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Dega Tiranë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, **të vendosë gjobë** për:

1. Znj. N.. M., me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet Rezonanca Magnetike MRI”, për diferencat në volume të konstatuara në objektin e mësipërm, si pasojë e të cilave është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën totale prej **438,140 lekë**.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa c, si dhe neni 15 të kontratave individuale të punës, **i rekomandoj** Titullarit të Spitalit Universitar të Traumës, për shkeljet e konstatuara në vlerësimin e procedurave të prokurimit, të japë masa disiplinore:

I. “Zgjidhja e menjëhershme e kontratës”,

Për **mjekjen nefrologe znj. J. D.**, në cilësinë e monitorueses së zbatimit të kontratës nr. 146 datë 15.04.2010 “*Për dhënien e shërbimit të dializës për pacientët, rinovuar për vitin 2014*”, në zbatim të nenit nr. 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime në kundërshtim me nenet nr. 23/1 dhe 24/1 të Kodit të Punës, pasi rakordimi mujor me S. A. është bërë me bazë mirëbesimi. SUT nuk disponon asnjë dokument monitorimi të këtij shërbimi, në kundërshtim të plotë me nenin 6 “Detyrimet dhe të drejtat e “blerësit” (SUT)” të kontratës, pika 6/2 ku citohet: “Blerësi (SUT), duhet të monitorojë cilësinë e shërbimit, bazuar në parametrat e cilësisë si, mortaliteti, malnutricioni, infeksionet, Kt/V, niveli i Hb, TA paradielizës, ditë qëndrimi në spital, organizimi i procedurave dialitike, skedat dhe kartelat e ndjekjes dhe mjekimit”, dhe pika 6/3 ku citohet: “Blerësi ka të drejtë të ushtrojë kontroll, nëpërmjet personave të autorizuar prej tij dhe që i bën të njohur “dhënësit”, për pritjen korrekte dhe informimin për pacientet që do të marrin shërbimin e dializës, sipas kësaj kontrate. Për kontrollet e ushtruara, mbahet procesverbali përkatës, i cili nënshkruhet edhe nga përfaqësuesi i dhënësit”. Përsa sipër, SUT ka paguar mbi bazë mirëbesimi S. A. për periudhën 01.01.2014 – 31.12.2014 në vlerën prej 116,561,314 lekë.

II. “Vërejtje” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”, duke gjykuar në bazë të përgjegjësisë rast pas rasti (të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit), për punonjësit si më poshtë:

1. F. B., në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderët “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2014”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2015”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2014”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi në procedurat e mësipërme të prokurimit janë bërë vlerësime të gabuara të ofertave duke bërë anulimin e procedurave apo shpalljen fitues në kundërshtim me ligjin.

2. M. Ll., në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderët “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2014”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2015”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2014”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi në procedurat e mësipërme të prokurimit janë bërë vlerësime të gabuara të ofertave duke bërë anulimin e procedurave apo shpalljen fitues në kundërshtim me ligjin.

3. E. O., në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi në procedurën e mësipërme të prokurimit është bërë vlerësim i gabuar i ofertave duke bërë shpalljen fitues në kundërshtim me ligjin.

4. M. S., në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi në procedurën e mësipërme të prokurimit është bërë vlerësim i gabuar i ofertave, duke bërë shpalljen fitues në kundërshtim me ligjin dhe në cilësinë e anëtarit së Njesisë së Prokurimit në tenderët “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi ka bërë planifikimin e gabuar të nevojave dhe vendosur në kundërshtim me ligjin kriteret e kualifikimit për “Shërbimi i rojeve private”.

5. E. R., në cilësinë e kryetarit të KVO në tenderin “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2015”, pasi në procedurën e mësipërme të prokurimit është bërë vlerësim i gabuar i ofertave duke bërë shpalljen fitues në kundërshtim me ligjin.

6. G. H., në cilësinë e anëtares së Njesisë së Prokurimit në tenderët “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2014”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2015”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2014”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi kanë bërë në kundërshtim me ligjin anulimin e procedurës, përdorimin e paargumentuar të procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe hartimin e KVK në tenderin “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, nuk ka parashikuar saktë nevojat për shërbimin e lavanderisë, janë

vendosur kritere të veçanta të kualifikimit në kundërshtim me LPP në tenderin “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina” dhe “Shërbimi i rojeve private”, ka bërë planifikimin e gabuar të nevojave dhe vendosur në kundërshtim me ligjin kriteret e kualifikimit për “Shërbimi i rojeve private”.

7. **A.. Zh..**, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Prokurimit në tenderët “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2014”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2015”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2014”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi kanë bërë në kundërshtim me ligjin anulimin e procedurës, përdorimin e paargumentuar të procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe hartimin e KVK në tenderin “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, nuk ka parashikuar saktë nevojat për shërbimin e lavanderisë, janë vendosur kritere të veçanta të kualifikimit në kundërshtim me LPP në tenderin “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina” dhe “Shërbimi i rojeve private”, ka bërë planifikimin e gabuar të nevojave dhe vendosur në kundërshtim me ligjin kriteret e kualifikimit për “Shërbimi i rojeve private”.

8. **G.. H..**, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në tenderët “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2014”, “Shërbimi i Lavanderisë në vitin 2015”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2014”, “Shërbimi i rojeve private në vitin 2015”, pasi kanë bërë në kundërshtim me ligjin anulimin e procedurës, përdorimin e paargumentuar të procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe hartimin e KVK në tenderin “Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohet aparatura e skanerit CT”, nuk ka parashikuar saktë nevojat për shërbimin e lavanderisë, janë vendosur kritere të veçanta të kualifikimit në kundërshtim me LPP në tenderin “Rikonstruksion i ambienteve ku do të zhvillojë aktivitetin Telemedicina” dhe “Shërbimi i rojeve private”, ka bërë planifikimin e gabuar të nevojave dhe vendosur në kundërshtim me ligjin kriteret e kualifikimit për “Shërbimi i rojeve private”.

9. **V.. S..**, në cilësinë e përgjegjësit të administratës, personi i ngarkuar në kontratë me ndjekjen e shërbimit për ruajtjen me roje private në SUT, pasi;

-Nuk ka zbatuar detyrimin për mbikëqyrjen gjatë kryerjes së shërbimit, nuk janë mbajtur aktkontrolle apo procesverbale për mangësitë e konstatuara në kryerjen e shërbimit.

-Për kontratat e zbatuara gjatë vitit 2015 me objekt ruajtjen me roje private, nuk është përgatitur raport përmbljedhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, duke mos zbatuar pikën 4 të nenit 77 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit: Alush Zaçe, përgjegjës grupi, Selime Bregu, Fadil Dekovi dhe Alketa Kalleshi, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT